



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

ZYRA E KRYETARIT
Sektori Pronëso-ro-Juridik

Me datë	10.12.2025
Referenca	INr.462/01-67427
Për	Drejtoratin për Administratë-Sektorit për punë të Kuvendit dhe Komiteteve
Nga	Gafurr Hetemi, Udhëheqësi i Sektorit Pronëso-ro-Juridik
Lënda	Dërgimi i propozim-Vendimit ref. INr.462/01-67427 datë 10.12.2025

Të nderuar,

Në mbështetje të nenit 13 paragrafi 13.4 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Komunës së Lipjanit, ju dërgojmë propozim-Vendimin ref. INr.462/01-67427 datë 10.12.2025 të Kryetarit të Komunës për ANULIMIN e vendimit INr.462-47684 të datës 29.09.2015 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të komunës të tokës bujqësore

Aktin e lartëcekur i'u dërgojmë edhe në formë elektronike –emailit zyrtar.

Aktet i'u dërgohen të përshkruar si në vijim;

- Propozim-Vendimin ref. INr.462/01-67427 datë 10.12.2025 të Kryetarit të Komunës për anulimin e vendimit INr.462/01-27002 të datës 29.05.2025 për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit INr.464-47684 të datës 29.09.2015 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të komunës zk-babush i muhaxherëve,
- Vendim për plotësimin e Vendimit INr.464-47684 të datës 29.09.2015 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të komunës, me numër të protokollit Nr.15-462/01-27002 të datës 29.05.2025,
- Shkresa e MAPL-së INr.462/01-33998 datë 08.07.2025



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 shkronja (h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28 datë 4 Qershor 2008, nenit 40 shkronja (h) dhe të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 datë 24.12.2021, Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës që:

Në mbështetje të nenit 12, 14, 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28 datë 4 qershor 2008, dhe nenit 9, 17, 20, të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 datë 24.12.2021, duke u bazuar në shkresën e MAPL-së. Lidhur me rishqyrtim e ligjshmerisë të 0204-1406/7 të datës 07.07.2025 të pranuar nga arkiva e Komunës me datë 08.07.2025 me numër të protokollit 1Nr.462/01-33998, në mbledhjen e mbajtur me datë _____ 2025 të miratojë këtë:

PROPOZIM

VENDIM

PËR ANULIMIN E VENDIMIT 15NR.462/01-27002 TË DATËS 29.05.2025 PËR
PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E VENDIMIT 1NR.464-47684 TË DATËS 29.09.2015
PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
TË KOMUNËS ZK-BABUSH I MUHAXHERËVE

Neni 1

Me këtë Vendim ANULOHET, Vendimi 15Nr.462/01-27002 i datës 29.05.2025 për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit 1Nr.464-47684 të datës 29.09.2015 për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të Komunës në ZK-Babush i Muhaxherëve.

Neni 2

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

A r s y e t i m

Baza ligjore për miratimin e këtij Propozim-Vendimi është e përcaktuar me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Statutit të Komunës së Lipjanit si dhe në Shkresën

përcjellëse të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal 0204-1406/7 të datës 07.07.2025 të pranuar nga arkiva e Komunës 1Nr.462/01-33998 të datës 08.07.2025.


Me Shkresën përcjellëse të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, është kërkuar rishqyrtimi i ligjshmërisë së aktit të lartë cekur, duke kërkuar miratimin e dy vendimeve të veçanta, fillimisht, Vendimi për plotësim dhe ndryshimin e Vendimit 1Nr.464-47684 të datës 29.09.2015 dhe pastaj të zhvillohen procedurat sipas legjislacionit në fuqi për dhënien në shfrytëzim për klubin futbollistik.

Përkitazi me këtë konsiderohet e arsyeshme që të bëhet anulimi i Vendimit në terësi, me qëllim të ndërmarrjes së veprimeve të metutjeshme për vendosjen e kësaj çështje, konform rekomandimeve të Ministrisë.

Nga të cekurat më lartë kërkojmë nga Kuvendi i Komunës që me qëllim të përmbushjes së Rekomandimeve të MAPL-së, të bëjë miratimin e këtij Propozim-Vendimi

1Nr. 462/01-67427
Datë: 10.12.2025

Kryetari i Komunës
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12, 14, 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28 datë 4 qershor 2008, dhe nenit 9, 17, 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 datë 24.12.2021, nenit 1 të Vendimit 1Nr.464-47684 datë 29.09.2015 dhe nenit 9 të Kontratës 1Nr.464-57074 datë 22.1.2016 për shfrytëzimin afatshkurtër prej 10 vitesh të pronës së paluajtshme, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 29.05.2025, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës mori këtë:

VENDIM

PËR PLOTËSIM DHE NDRYSHIMIN E VENDIMIT 1NR.464-47684 TË DATËS 29.09.2015 PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË PRONAVE TË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

Neni 1

1. Me këtë Vendim ndryshohet dhe plotësohet neni 1 i Vendimit për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të komunës, 1Nr.464-47684 datë 29.09.2015, të pjesa tabelare me numër rendor 4 dhe riformulohet si në vijim;

Nr.	Pronar	Zona Kadastrale	Ngastra kadastrale	Sipërfaqja
1	KK-Lipjan	Babush i Muhaxherëve	P-71409059-00559-8 P-71409059-00559-5	45669 ²

Neni 2

2. Ndryshimi dhe plotësimi i nenit të cekur më lartë, bëhet duke u bazuar në kërkesën 1Nr.465/02-25830 datë 23.05.2025 e shfrytëzuesit aktual, i cili ka kërkuar që të heqë dor nga e drejta e shfrytëzimit në ngastrën kadastrale P-71409059-00559-0 të pjesës së sipërfaqes prej 25000m² nga sipërfaqja e përgjithshme prej 70669m² tokës-pasuri shoqërore e KK-Lipjan në ZK-Babush i Muhaxherëve.

Neni 3

AUTORIZOHET, Kryetari i Komunës që menjëher pas hyrjës në fuqi të këtij Vendimi të ndryshoj dhe plotësoj kontratën 1Nr.464-57074 datë 22.1.2016 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër prej 10 vitesh, në pajtim me dispozitat e këtij Vendimi.

Neni 4

Obligohet Drejtorati për Kadaster dhe Gjeodezi, të bëjë ndarjen-parcializimin sipas nenit 2 të këtij Vendimi.

Neni 5

Pas hyrjës në fuqi të këtij Vendimi, pjesa e sipërfaqes prej 25000m², destinohet për klubin futbollistik KF "Gadimja", me qëllim të promovimit dhe masivizimit të sportit të futbollit për të gjitha moshat.

Neni 6

Zyra e Kryetarit-Sektori Pronësoho-Juridik, obligohet të jepë Pëlqim për dhënien në posedim të pjesës së sipërfaqës 25000m² së parceles kadastrale P-71409059-00559-8 për klubin futbollistik KF "Gadimja" lidhur me realizimin e investimeve në promovimin dhe masivizimit në fushen e sportit.

Neni 7

Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Zyra e Kryetarit-Sektori Pronësoho-Juridik, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati për Kadastër dhe Gjeodezi, Drejtorati për Infrastrukturë dhe Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.

Neni 8

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në ueb-faqen zyrtare të Komunës.

Nr. 15-462/01-27002


Lipjan, më 29.05. 2025

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi





Pratje e: 08.07.2025		
Nr. Dokumenti	Nr. Dokumenti	Shtojca
01-462/01-33998		Dedatsh

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës së Lipjanit Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Lipjanit
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm në MAPL
Nga:	Erbilin Hetemi, Drejtor i Departamentit Ligjor Data: 10.06.2025 II-0204-1406/6
Zyrtaret përgjegjës:	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunës dhe të Kryetarit Leonora Bajrami, Zyrtare e Lartë për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunës
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtim
Lloji i aktit:	Vendim i kuvendit të komunës së Lipjanit

Inderuar Kryetar,
Inderuar Kryesues,

Në pajtim me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshimplotësimin e Rregullos (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 14/2023 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimi Nr.15-462/01-27002 për plotësim dhe ndryshimin e vendimit 1 Nr.464-47684 të datës 29.09.2015 për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të komunës
I miratuar më datë: 29.05.2025
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 30.05.2025

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës nuk është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Lipjanit në mbledhjen e mbajtur me datë 29.05.2025, ka miratuar Vendimin Nr.15-462/01-27002 për plotësim dhe ndryshimin e vendimit 1 Nr.464-47684 të datës 29.09.2015 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të komunës i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Lipjanit.

MAPL, konstaton se brenda një vendimi janë zhvilluar dy procedura, nenin 1 plotësohet-ndryshohet vendimi 1 Nr.464-47684 të datës 29.09.2015 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të komunës, ndërsa neni 5 destinim i pronës për klubin futbollistik.

Prandaj kuvendi i komunës së Lipjanit duhet të miratoj vendime të veçanta, fillimisht të miratoj vendimin për plotësim ndryshim të vendimit 1 Nr.464-47684 të datës 29.09.2015 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të komunës, më pas të zhvilloj procedurat sipas legjislacionit në fuqi për dhënien në shfrytëzim të pronës për klubin sportiv.

Bazuar në të lartcekurat, Kuvendi i Komunës së Lipjanit, duhet të ndërmerri veprime dhe brenda afatit ligjor, prej 30 ditëve, të rishqyrtoj dhe të harmonizoj aktin me legjislacionin në fuqi.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbete në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.